



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2020:077148  
Datë: 24.01.2024  
Numri i dokumentit: 05232549

C.nr. 2975/2020

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florian Krasniqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.P, të cilin e përfaqëson avokat B.B, me adresë në Rr. “.....”, Prishtinë, kundër të paditurës, Ministria “.....”, përfaqësuar nga “.....”, me objekt kontesti: anulimin e vendimit, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik, me datë 11.01.2024 mori dhe me datë 24.01.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET** në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit F.P, kundër të paditurës Ministria “.....”, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i komisionit brendshëm disiplinor nr. 056/KBD/20 i datës 16.01.2020 si dhe vendimi i komisionit për ankesa nr. 60-KA-2020 i datës 23.03.2020 dhe të obligohet e paditura që paditësit t’i mundësohet vazhdimi i procesit të testimit me gojë për gradim në gradën toger sipas procedurës së ndërprerë për gradimin në gradën toger sipas vendimit të datës 29.09.2020 i lëshuar nga komisioni për procesin e gradimit me gradën toger pranë “.....”.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi me datë 29.06.2020 pranë kësaj Gjykate ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit për shqiptimin e masës disiplinore ndaj paditësit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në padi përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar që paditësi është gjetur fajtor nga Komisioni i Brendshëm Disiplinor, me vendimin nr. 056/KBD/20 të datës 16.01.2020, me arsyetimin se me datë 08.08.2019, rreth orës 13:42 derisa kishte qenë në detyrë zyrtare me pozitë udhëheqës i ndërrimit, kishte dështuar në përmbushjen e përgjegjësiave dhe detyrave të caktuara, kur së bashku me zyrtarin B.M, i ishin përgjigjur rastit të aksident trafikut në udhëkryqin e rrugëve “.....” dhe “.....” në “.....”, në të cilën kishin qenë të involvuara dy vetura, njëra kishte qenë vetura e ankuesit S.U, që kishte pasur dëme materiale dhe se paditësi nuk i kishte marrë masat e duhura gjatë kryerjes së detyrës duke mos e informuar hierarkinë komanduese të “.....” në “.....”, lidhur me rastin e aksident trafikut në datën kur kishte ndodhur.

Po ashtu ka shtuar se nga shkeljet sipas të cilave ishte gjetur fajtor paditësi në procedurë disiplinore, është se i njëjti ka shtrembëruar faktet dhe nuk ka treguar datën dhe kohën e saktë se kur kishte ndodhur aksidenti. Ka shtuar se ndaj vendimit për shqiptimin e masës disiplinore (ndalesë 30% e pagës mujore për tre muaj), paditësi ka paraqitur ankesë interne pranë të paditurës, ankesë kjo e cila është refuzuar nga shkalla e dytë e të paditurës. Tutje ka theksuar se, shkeljet e pretenduara nga e paditura në procedurën për shqiptimin e masës disiplinore nuk përkojnë fare me gjendjen faktike reale, kjo për faktin se paditësi në procedurë disiplinore është gjetur fajtor kinse se i njëjti ka bërë falsifikim, shkatërrim apo dëmtim të dokumentit zyrtar, ndërsa një konstatim i tillë i komisionit disiplinor të të paditurës nuk qëndron për faktin se në rastin me të cilin ngarkohet paditësi, është shqiptuar tiketa kundërvajtëse, ndërsa paditësi nuk ka bërë asnjë falsifikim të kësaj tikete, sepse në ditën kur është shqiptuar kjo tiketë kundërvajtëse paditësi atë ditë nuk ka qenë në detyrë fare. Ka shtuar se nuk ekziston asnjë provë e vetme që paditësi të ketë tentuar që të bëjë ndonjë shtrembërim të fakteve apo të ketë deklaruar rrejshëm lidhur me shqiptimin e tiketës kundërvajtëse. Tutje ka theksuar se, ditën kritike kur kishte ndodhur aksidenti mes dy veturave të aksidentuara, nuk kishte pasur fare patrullë “.....” andaj një gjë të tillë e kishte bërë vet paditësi, me qëllim që ti përgjigjet kërkesave të shumta që kishte pasur atë ditë, dhe që pasi kishin shkuar në vendin e ngjarjes, nga personat e implikuar në aksident ishte kumtuar se nuk vërehet të ketë pasur dëme dhe se të njëjtit nuk kishin dëshiruar që të hapin rast në “.....”, kurse më vonë pala e dëmtuar në aksident S.U, kishte ardhur tek paditësi dhe i kishte thënë se e kishte dërguar veturën tek ndonjë mekanik dhe se nuk vërehen dëme, dhe nuk ka kërkuar inicim të rastit por vetëm një vërtetim për aksidentin, në rast se i nevojitet në “.....” ku e kishte të siguruar automjetin. Tutje ka shtuar se nuk qëndrojnë gjetjet e komisionit disiplinor të të paditurës se paditësi kishte bërë fshehje të rastit, për faktin se në vendin e ngjarjes ishte bërë fotografimi, skicimi dhe se ishte marr dokumentacioni nga palët, dhe se të njëjtat ishin ftuar të nesërmen për të dhënë deklaratat dhe të hapin rastin.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se, ashtu siç është elaboruar në referatin e padisë, paditësi i është shqiptuar masë disiplinore në kundërshtim me aktin e brendshëm të punëdhënësit Udhëzimit Administrativ 05/2017 DPP e cila korrespondon edhe me Udhëzimin Administrativ 04/2019 DPP lidhur me nenin 43 të Ligjit për Policinë e Kosovës. Ka theksuar se, masa e shqiptuar është bërë edhe në kundërshtim me gjendjen reale faktike të cilën komisioni disiplinor si dhe komisioni për ankesa kanë dështuar që ta gjykojnë drejte. I ka propozuar Gjykatës që padia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të anulohet vendimi i komisionit brendshëm disiplinor 056/KBD/20 i datës 16.01.2020 si dhe vendimi i komisionit për ankesa nr. 60-KA-2020 i datës 23.03.2020 dhe të obligohet e paditura që paditësit t’i mundësohet vazhdimi i procesit të testimi me gojë për gradim në gradën toger sipas procedurës së ndërprerë për gradimin në gradën toger sipas vendimit të datës 29.09.2020 i lëshuar nga komisioni për procesin e gradimit me gradën toger pranë “.....”. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

E paditura në përgjigje në padi, dhe në seancën e shqyrtimit kryesor ka theksuar se, paditësi është gjetur fajtor në procedurë disiplinore, për shkak se duke qenë në detyrë zyrtare me pozitë “.....”, kishte dështuar përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisive, për shkak se në aksidentin

e komunikacionit të ndodhur në udhëkryqin e rrugëve “.....” dhe “.....” në “.....”, nuk kishte marrë masat e duhura, duke mos e informuar hierarkinë komanduese të “.....” në “.....” lidhur me rastin, dhe të nesërmen me datë 09.08.2019, përmes telefonit e kishte njoftuar rreshter A.Ç.D duke shtrembëruar faktet dhe duke mos treguar kohën dhe datën e saktë se kur kishte ndodhur aksidenti. Ka shtuar tutje se, paditësi së bashku me kolegun e tij nuk kishin iniciuar rast deri me datë 20.08.2019, kur ankuesi (i përfshirë në aksident ) kishte shkuar në stacion policor për ta kërkuar raportin e aksidentit, dhe vetëm pas kësaj, me urdhër të operativës së stacionit policor ishte iniciuar rasti aksident trafiku me nr. “.....” dhe shkaktarit të aksidentit i ishte shqiptuar tiketa kundërvajtëse për shkak se i njëjti nuk kishte policë të sigurimit dhe regjistrim. Ka theksuar se e paditura ka zhvilluar procedurën disiplinore sipas rregullave ligjore, duke administruar një tërësi provash në seancë jo dëgjimore, dhe duke marrë deklaratat edhe nga vet paditësi, dhe pas administrimit të provave ka ardhur në përfundimin që paditësit ti shqiptohet masa disiplinore e ndalesës së pagës 30% bruto për tre muaj. Ka theksuar se e kundërshtojnë padinë e paditësit edhe për faktin se, procesi i gradimit zhvillohet gjatë një procesi në afate të caktuara dhe nuk mund të ripërtërihet - zhvillohet për një person të caktuar dhe atë jashtë afateve. I ka propozuar Gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata, bazuar në propozimet e palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit, dhe në këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat si në vijim: vendimi i komisionit për ankesa date 23.03.2020 nr. 60-KA-2020, raporti policor i aksidentit datë 08.08.2019, nr. 2019-AF-0662, raporti i oficerit nr. 2019/0905 i datës 09.08.2019, vendimi i komisionit të brendshëm disiplinor nr. 056/KBD/20 i datës 16.01.2020, raporti përfundimtar i hetimeve me rekomandim për lëndën disiplinore ndaj punonjëseve të P.K nr. Ref. 0514-PK-2019 i datës 18.11.2019, raporti i përgjithshëm i hetimeve nr. 0514-PK-2019, kërkesë për paraqitjen e disiplinës se brendshme nr. Ref. 04/1-01SR R-2686, i datës 23.08.2019, kërkesë për paraqitjen e disiplinës se brendshme nr. Ref. 04/1-01-PO-121/19, formular i paraqitjes se disiplinës se brendshëm, përmbledhje për shkeljen e supozuar, komunikimet elektronike – email-at, dokumenti i titulluar “Radiologu” i datës 08.08.2019, orari ditor i datës 08.08.2019, deklarata për aksident trafiku nr. 2019-AF-0662, fletëparaqitje për kundërvajtje e datës 08.08.2019, njoftim zyrtar për hetim te brendshëm nr. 0514-PK-2019 për policin F.P, i datës 23.09.2019, procesverbali mbi intervistën e dëshmitarit i datës 24.10.2019, procesverbali mbi intervistën i datës 04.11.2019, lista e aplikantëve për gradën toger – diskualifikim e datës 25.09.2020, vendimi i të paditurës i datës 29.09.2020.

Gjykata, pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në nenin 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim si: LPK), erdhi në përfundimin se padia e paditësit është në tërësi e pabazuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi është në marrëdhënie pune me të paditurën. Po ashtu ishte kontestuese se ndaj paditësit ishte zhvilluar procedura e brendshme disiplinore në lidhje me shkeljet e detyrave të punës.

Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, ishin faktet, nëse procedura disiplinore ishte zhvilluar

sipas procedurave ligjore, nëse masa e shqiptuar ishte adekuate me shkeljet e detyrave të punës dhe nëse komisioni që kishte udhëhequr procedurën disiplinore tek e paditura, kishte bërë vërtetim të drejtë të gjendjes faktike.

Nga kërkesa për paraqitjen e disiplinës së brendshme nr. Ref. 04/1-01-PO-121/19 dhe formular i paraqitjes së disiplinës së brendshme, vërtetohet se personat e autorizuar pranë të të paditurës, kishin iniciuar zhvillimin e procedurës disiplinore ndaj paditësit, me arsyetimin se i njëjti kishte bërë shkelje të detyrave të punës, gjegjësisht se me datë 08.08.2019 paditësi së bashku me kolegun e tij të punës, kishin dalur në vendin e ngjarjes, ku kishte ndodhur një aksident komunikacioni, dhe të njëjtit nuk kishin kompletuar dokumentacionin e rastit, por i kishin marr dokumentet e palëve të përfshira në aksident, dhe palën e dëmtuar e kishin udhëzuar që të vijë në stacion për pranim të raportit të aksidentit, pra nuk i kishte përmbushur detyrat e punës duke mos e kompletuar dokumentacionin e lëndës. Tutje në kërkesën për paraqitjen e disiplinës së brendshme, theksohet, paditësi ditën e nesërme kishte përpiluar raportin e oficerit, dhe në të kishte theksuar se, pala e dëmtuar nuk kishte dashur që të inicioje rast pranë policisë së Kosovës, kjo për faktin se dëmet ishin të vogla. Tutje në këto prova theksohet se paditësi ditën e nesërme, datë 09.08.2019 e kishte kontaktuar eprorin e tij, “.....” në “.....”, duke i thënë se për aksidentin e ndodhur, palët e përfshira në aksident nuk kanë dashur që të hapin rast pranë “.....”, dhe sipas këtij dokumenti theksohet se eprori i tij, i kishte komunikuar paditësit se meqenëse është në vendngjarje duhet të bëjë raport dhe të marr deklaratat e palëve të përfshira në aksident, në mënyrë që të njëjtit të deklarojnë që nuk ka dëme dhe nuk dëshirojnë inicim të rastit.

Nga komunikimi me email në mes të eprores A.Ç dhe paditësit, rezulton se A.Ç në cilësinë e eprores së paditësit, të njëjtit i kishte shënuar email me datë 05.09.2019 duke kërkuar raport nga pala paditëse lidhur me aksidentin e datës 09.08.2019, dhe duke kërkuar nga i njëjti sqarime se pse nuk i është shqiptuar shkaktarit të aksidentit tiketë kundërvajtëse për shkak të drejtimit të automjetit pa polisë të sigurimit dhe pse është lejuar drejtimi i mëtutjeshëm i automjetit pa policë të sigurimit. Tutje në komunikimet me email po ashtu rezulton se eprorja A.Ç kishte kërkuar sqarime nga paditësi se pse tiketa e shqiptuar figuron se është shqiptuar me datë 08.08.2019, përderisa e njëjta është shqiptuar me datë 21.08.2019, dhe po ashtu targat e veturës së shkaktarit të aksidentit, figuron se janë konfiskuar përkohësisht me datë 08.08.2019, ndërsa konfiskimi i përkohshëm i targave në të vërtetë ka ndodhur me datë 21.08.2019.

Nga deklarata për aksident trafik, e dhënë nga pala e përfshirë në aksident, vërtetohet fakti se njëra nga palët e përfshira në aksident S.U, kishte dhënë deklaratë pranë stacionit policor në “.....”, me datë 20.08.2019, ndërsa nga deklarata për aksident trafik, e dhënë nga pala e përfshirë në aksident, vërtetohet fakti se pala tjetër e përfshirë në aksident F.H, kishte dhënë deklaratë pranë stacionit policor në “.....”, me datë 21.08.2019.

Nga njoftimi zyrtar për hetim të brendshëm nr. 0514-PK-2019 për paditësin F.P, i datës 23.09.2019, vërtetohet fakti se paditësi ishte informuar nga organet kompetente të të paditurës për inicimin e procedurës së brendshme disiplinore për shkak të shkeljeve eventuale të detyrave të tij punës.

Nga procesverbali mbi intervistën e dëshmitarit i datës 24.10.2019, procesverbali mbi intervistën i datës 04.11.2019, vërtetohen faktet se, gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore, paditësi ishte ftuar nga komisioni disiplinor i të paditurës për intervistimin në lidhje me shkeljet e pretenduara të detyrave të punës, e po ashtu si dëshmitare ishte dëgjuar nga komisioni edhe A.Ç.

Komisioni për udhëheqjen e procedurës disiplinore, pas zhvillimit të procedurës disiplinore kishte paraqitur raportin përfundimtar të hetimeve, raporti i datës 18.11.2019, dhe në këtë raport përfundimtar kishte rekomanduar shqiptimin e masës disiplinore për paditësin, ndalesë 30% të pagës bruto për tre muaj për paditësin.

Me vendimin nr. 056/KBD/20 të datës 16.01.2020, Komisioni i brendshëm disiplinorë paditësit i kishte shqiptuar masën ndalesë 30% të pagës bruto për tre muaj për paditësin. Ndaj këtij vendimi paditësi brenda afatit ligjor kishte paraqitur ankesë pranë komisionit për ankesa tek e paditura, dhe komisioni për ankesa me vendimin nr. 60-KA-2020, të datës 23.03.2020, kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit.

Nga lista e aplikantëve për gradën toger – diskualifikim e datës 25.09.2020, vërtetohet fakti se paditësi në kohën e shqiptimit të masës disiplinore, kishte qenë në procedurë për avancimin në gradën toger, dhe si pasojë e shqiptimit të masës disiplinore, paditësi ishte diskualifikuar nga konkursi për gradim në gradën toger.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, Gjykata vlerëson se kërkesë padia e paditësit është në tërësi e pabazuar. Kjo për faktin se nga provat e administruara, rezulton se procedura disiplinore është zhvilluar konform dispozitave ligjore, dhe brenda afateve të parapara ligjore. Sipas vlerësimit të gjykatës, e paditura në mënyra ligjore e ka zbatuar procedurën disiplinore, siç edhe shihet në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, në të cilin është arsyetuar në tërësi rrjedha e procedurës disiplinore ndaj paditësit. Përgjatë zhvillimit të procedurës disiplinore, paditësit i është dhënë mundësia që të paraqesë argumentet e veta gjatë intervistimit, dhe po ashtu ofrimi i provave.

Sipas raportit përfundimtar të hetimeve, raporti i datës 18.11.2019, dhe raportit të përgjithshëm të hetimeve, me nr. 0514-PK-2019, rezulton se komisioni hetimor pranë të të paditurës kishte paraqitur në mënyrë të detajuar, se paditësi në datën 08.08.2019, kur në cilësinë e “.....” kishte shkuar në vendin ku kishte ndodhur aksidenti i komunikacionit, dhe kishte përpiluar raport, me nr. 2019/0905 se pala e përfshirë në aksident S.U, nuk kishte qenë i interesuar për hapjen e rastit, ndërsa paditësi ditën e ndodhjes së aksidentit nuk kishte informuar eprorët e tij në hierarkinë komanduese, por me datën 09.08.2019 (një ditë pas aksidentit), paditësi e kishte telefonuar rreshterin A.Ç, duke i raportuar për aksidentin, por pa i treguar për datën dhe vendin e ndodhjes së saktë të aksidentit. Sipas këtyre raporteve, pala e dëmtuar në aksident, S.U po të njëjtën ditë (ditën e ndodhjes së aksidentit 08.08.2019) kishte shkuar pranë stacioni policor në “.....”, dhe kishte kërkuar raportin e aksidentit, dhe pasi që paditësi nuk kishte qenë në stacionin policor, pala e dëmtuar ishte udhëzuar që ditën e nesërme të paraqitet në stacionin policor, pra me datë

09.08.2019, dhe edhe pse kishte shkuar në stacion policor me datë 09.08.2019, prapë nuk ishte pajisur me raportin e aksidentit të trafikut, kjo sepse nuk ishte iniciuar fare rasti për aksident trafiku. Po ashtu sipas këtyre raporteve të hetimeve, komisioni i hetimeve të të paditurës kishte gjetur se, paditësi (së bashku me kolegun e tij në “.....”) nuk e kishin kompletuar dokumentacionin e plotë ditën e ndodhjes së aksidentit, ashtu që i kishin marrë të gjitha dokumentet e palëve të përfshira në aksident, por nuk kishin ndërmarrë asnjë veprim ligjor ndaj shkaktarit të aksidentit, pasi që shkaktari i aksidentit të komunikacionit ishte duke drejtuar automjetin pa polisë të vlefshme të sigurimit – pra automjetin e pa regjistruar. Po ashtu raportet e hetimeve kishin gjetur se, ndonëse nga paditësi ishte kërkuar përmes emalit që të dorëzonte raportin policor lidhur me rastin aksident trafiku, i njëjti nuk e kishte dorëzuar fare raportin policor tek rreshterja A.Ç. Të gjitha këto veprimet janë përshkruar edhe në vendimin për shqiptimin e masës disiplinore ndaj paditësit 056/KBD/20 i datës 16.01.2020.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, të gjeturat e raportit të hetimeve nga komisioni i brendshëm hetimor, si dhe konstatimet e shkeljeve të përshkruara në vendimin 056/KBD/20 i datës 16.01.2020 për shqiptimin e masës disiplinore, rezultojnë se janë në përputhje edhe me provat tjera të administruara në shqyrtim gjyqësor. Kjo për faktin se nga dokumenti i titulluar orari ditor, rezulton se me datë 08.08.2019 paditësi kishte qenë “.....”, dhe së bashku me kolegun e tij kishte qenë përgjegjës për monitorimin e parkimeve të parregullta dhe për përgjigje në raste të lajmëruara. Po ashtu, si provë është administruar edhe raporti i oficerit i hartuar nga paditësi, dhe rezulton se ky raport është hartuar me datë 09.08.2019, ndërsa i njëjti raport nuk ishte hartuar në ditën e ndodhjes së aksidentit të komunikacionit. Ndërsa nga raporti policor i aksidentit, vërehet se ky raport ishte hartuar me datë 20.08.2019, ndërsa nuk ishte hartuar në ditën e ndodhjes së aksidentit, pra datën 08.08.2019, për çka edhe ishte vlerësuar si shkelje e detyrave të punës nga komisioni disiplinor i të paditurës. Po ashtu, edhe nga deklaratat e dhëna në stacion policor nga palët e përfshira në aksidentin e trafikut, rezulton se këto deklarata janë dhënë me datën 20 respektivisht 21 gusht të vitit 2019 nga pjesëmarrësit në aksident, dhe rrjedhimisht rezulton se deklaratat e palëve të përfshira në aksident trafiku, nuk ishin marrë në ditën e ndodhjes së aksidentit, datë 08.08.2019, e as ditën e nesërme 09.08.2019 siç e kishin udhëzuar palën e dëmtuar që të paraqitet në stacionin policor në “.....”.

Në këtë kuptim, me nenin 43 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, parashihet se: *1. Të gjitha shkeljet disiplinore, ku përfshihet punonjësi i Policisë së Kosovës, përveç rasteve të parapara në Ligjin për Inspektoratin Policor hetohen dhe vendoset nga Policia e Kosovës. 2. Shkeljet, masat dhe procedura disiplinore rregullohen me akt nënligjor.* Sipas udhëzimit administrativ nr. 04/2019, për shkeljet, masat dhe procedura disiplinore, gjegjësisht në nenin 20, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 parashihet se shkelje e rëndë diskredituese e zyrtarëve policor paraqet rastet kur *1.1. Pa ndonjë arsye të ligjshme shkatërron, dëmton falsifikon, shtrembëron apo fsheh ndonjë dokument të konsiderohet zyrtar apo dëshmi, ose ndryshon, fshin apo shton ndonjë të dhënë në të,* ndërsa me nenin 21, par. 1, nën paragrafi 1.1 të këtij Udhëzimi Administrativ parashihet: *1.1. Pa ndonjë arsyetim të ligjshëm nuk e zbaton, shmang, refuzon të bashkëpunojë apo komprometon ndonjë urdhër nga autoriteti kompetent,* ndërsa me nenin 24, par. 1, nën paragrafi 1.1 të udhëzimit administrativ në fjalë parashihet: *1.1 Pa ndonjë arsye bindëse nuk i përmbush apo*

*dështon në përmbushjen detyrave dhe përgjegjësiive caktuara, si pasojë e të cilave kanë shkaktuar apo kanë mundur të shkaktojnë efekte negative në efikasitet, reputacionin e Policisë dhe dëmtimin e të drejtave të të tjerëve. Me nenin 42, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të këtij udhëzimi administrativ parashihet që, Masat për shkelje të rënda disiplinore për punonjësit e PK-se, 1.4. Ndalesën në pagë mbi 20% deri në 30% të pagës mujore bruto prej dy deri në gjashtë muaj.*

Në funksion të kësaj, Gjykata vlerëson se, sipas të gjeturave të komisionit të brendshëm të të paditurës, tek paditësi janë vërtetuar shkelje të detyrave të punës, se shkeljet në fjalë janë të sanksionuara me udhëzimin administrativ të lartë cituar, se veprimet e paditësit janë kualifikuar nën normën e duhur të udhëzimit administrativ që përcakton shkeljet e detyrave të punës, dhe se po ashtu edhe masa e shqiptuar është e përcaktuar me normat e udhëzimit administrativ në fjalë, dhe sipas të gjitha këtyre konstatimeve, rezulton se e paditura nuk ka bërë shkelje me rastin e zhvillimit të procedurës disiplinore. Po ashtu, e paditura me rastin e nxjerrjes së vendimit për shqiptimin e masës disiplinore, ka arsyetuar veprimet konkrete të shkeljeve të detyrave të punës nga ana e paditësit, e po ashtu ka arsyetuar edhe arsyeshmërinë e shqiptimit të masës disiplinore ndalesë e 30% të pagës bruto, për tre muaj. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, masa e shqiptuar ndaj paditësit, është adekuate vlerësuar në raport me shkeljet e detyrave të punës. Vendimi për shqiptimin e masës disiplinore është i hartuar qartë, dhe i njëjti përmban në mënyrë të detajuar shkeljet për të cilat është gjetur fajtor paditësi në procedurë disiplinore, veprimet me të cilat janë konkretizuar këto shkelje të detyrave të punës, provat të cilat janë administruar dhe në tërësi zhvillimin e procedurës disiplinore, deri në shqiptimin e masës.

Gjykata po ashtu vë në dukje se, sa i përket pretendimit të palës paditëse se tiketa kundërvajtëse e shqiptuar ndaj shkaktarit të aksidentit me datën 20.09.2019 ishte shqiptuar nga kolegu i tij, e jo nga vet paditësi, ngase paditësi kishte qenë në pushim javor, Gjykata e vlerëson pa ndikim në një vendim ndryshe nga ajo në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kjo për fakti se, masa disiplinore ndaj paditësit ishte shqiptuar për shkak se raporti i aksidentit dhe tiketa kundërvajtëse nuk ishte hartuar gjegjësisht shqiptuar në ditën e ndodhjes së aksidentit, pra paditësi nuk kishte kompletuar dokumentacionin e rastit të ndodhur, dhe në këtë kuptim është jo relevante nëse paditësi nuk ka kontribuar në hartimin e raportit policor të aksidentit me datën 20.08.2019.

Bazuar në të lartë cekurat, gjykata vlerëson se pjesa e kërkesë padisë së paditësit, me të cilin ka kërkuar anulimin e vendimit të komisionit brendshëm disiplinor 056/KBD/20 i datës 16.01.2020 si dhe vendimi i komisionit për ankesa nr. 60-KA-2020 i datës 23.03.2020 është e pabazuar.

Ndërsa sa i përket pjesës së kërkesëpadisë me të cilën paditësi ka kërkuar që të obligohet e paditura që procedurën e ndërprerë për gradimin në gradën toger sipas vendimit të datës 29.09.2020 i lëshuar nga komisioni për procesin e gradimit me gradën toger pranë “.....”, ashtu që paditësit t’i mundësohet vazhdimi i procesit të testimit me gojë për gradim në gradën toger, gjykata po ashtu vlerëson se është e pabazuar. Kjo për faktin se kjo pjesë e kërkesë padisë është e ndërlidhur me anulimin e vendimit për shqiptimin e masës disiplinore, ngase diskualifikimi nga konkursi për gradën toger kishte ardhur si pasojë e vet masës së shqiptuar disiplinore, dhe

përderisa nga konstatimet e gjykatës si më lartë, vendimi për shqiptimin e masës disiplinore është i ligjshëm, rezulton se paditësit nuk i është krijuar baza ligjore për të kërkuar edhe vazhdimin e procesit të gradimit. Për më tepër, Gjykata po ashtu sjell në vëmendje se, në kontestet që derivojnë nga marrëdhëniet e punës, Gjykata kufizohet në vlerësimin nëse me rastin e shqiptimit të masës disiplinore janë zbatuar dispozitat ligjore, dhe masa e shqiptuar është adekuate me shkeljet e detyrave të punës, dhe në rastet kur vërtetohet se ka shkelje nga marrëdhënie e punës, Gjykata detyron të paditurën për kompensimin adekuat, ndërsa nuk është në domenin e Gjykatës për ta detyruar të paditurën që të organizojë konkurse për gradime në pozita më të larta në vendin e punës, që paraqet kërkesë të paditësit në rastin konkret.

Vendimin nga pika II e dispozitivit të aktgjykimit, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta gjykata e mbështet në dispozitën e nenit 450 të LPK-së, e cila përcakton: *Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.*

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, bazuar në nenin 160 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-**

Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. 2975/2020, datë 24.01.2024

**Gjyqtari**  
**Florian Krasniqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.